

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Lumni Sallauka - kryetar i kolegjit, Rafet Haxhaj dhe Burim Shala anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses ish Kasabank tani NLB Prishtina sh.a, me seli në Prishtinë, rr.“Rexhep Luci” nr.5, të cilën me autorizim e përfaqësojnë I.S., nga Prizreni dhe A.K. nga Prishtina, kundër të paditurve E.K. dhe GJ.K., që të dy nga fshati ..., Komuna e Suharekës dhe N.T.SH. “NN”, me seli në Prizren, rr.“...”, nr.//, për shkak të kthimit të kredisë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit të parë të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.886/07, të datës 10.01.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **26.11.2018**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e të paditurit E.K. nga fshati ..., Komuna e Suharekës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.886/07, i datës 10.01.2014, në pikën I, **VËRTETOHET**.

II. Pika II dhe III e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.886/07, i datës 10.01.2014, mbeten të pashqyrtuara.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.886/07, të datës 10.01.2014, në pjesën e parë të dispozitivit e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses Kasabank tani NLB Prishtina, sh.a. me seli në Prishtinë dhe ka obliguar të paditurin e parë E.K. nga fshati ..., Komuna e Suharekës, që në emër të kthimit të kredisë, paditësit t’ia paguajë shumën prej 11.938,27 euro, të gjitha këto brenda 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcenim të ekzekutimit me dhunë. Në pjesën e dytë të dispozitivit ka konstatuar të tërhequr padinë e paditësit Kasabank tani NLB Prishtina, sh.a. me seli në Prishtinë, kundër të paditurit të dytë GJ.K., nga fshati ..., Komuna e Suharekës dhe të paditurit të tretë N.T.SH. “NN”, me seli në Prizren. Ndërsa me pjesën e tretë të dispozitivit ka vendosur që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka paraqitur ankesë i padituri i parë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë të aprovoj ankesën e të paditurit si të bazuar, aktgjykimi i atakuar të ndryshohet ashtu që të refuzohet në terësi kërkesëpadia e paditësit ose i njëjti të prishet dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesën e të paditurit nuk ka pasur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurit është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me datë 11.06.2007, fillimisht në Gjykatën Komunale në Suharekë, paditësja ka paraqitur padi kundër të paditurve, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet të paditurit që në emër të kredisë së pakthyer, t'ia paguajnë paditësit shumën prej 11.742,75 euro, me kamatë vjetore 11% dhe kamatëvonesë vjetore 4.5%, duke e llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë e deri në ditën e pagesës definitive, si dhe shpenzimet procedurale në afat prej 15 ditëve pas plotëfuqishmerisë së aktgjykimit, nën kërcenim të ekzekutimit me dhunë.

Gjykata Komunale në Suharekë me aktvendimin C.nr.133/07, të datës 06.12.2007, është shpallë jokompetente territoriale dhe lëndore për zgjidhjen e çështjes juridiko-civile dhe konform nenit 47 pika 1 dhe nenit 52 të LPK-së, komplet lënda i është dorëzuar Gjykatës Komunale (tani Themelore) në Prizren, si gjykatë kompetente.

Gjykata Themelore në Prizren si gjykatë e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.886/07, të datës 10.01.2014, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se si provë ka administruar kontratën e kredisë për përmirësimin e kushteve të banimit dhe atë me riprogramimin e borxhit, nr.13/06, të datës 03.04.2006, e lidhur ndërmjet paditësit dhe të paditurit, marrëveshjen e garancisë, nr.13/06, e datës 03.04.2006, dhënë nga garantuesi H. K., në emër të N.T.SH. "NN", pasqyrën e detyrimeve të të paditurit e dhënë nga paditësi, e datës 10.01.2014. Pas administrimit të provave të lartëcekura dhe pranimit të kërkesëpadisë nga vet i padituri i parë, gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar faktin se i padituri ka obligim që në emër të kthimit të kredisë së marrë, t'ia paguajë paditësit shumën prej 11.938,27 euro, kjo bazuar në nenin 17 dhe 262 të LMD-së. Ndërsa lidhur me pikën II të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar me të cilën gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se është terhequr padia ndaj të paditurit të dytë dhe të tretë, gjykata e shkallës së parë ka vendosur në kuptim me nenin 261 paragrafi 3 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për shkeljet që i referohen konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljeve tjera nga neni 182.2 pika n), pasi që arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje me dispozitivin e nenit 160 paragrafi 4 dhe 5 i LPK-së, meqë gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet e çështjes, për provat të cilat i ka shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe për vlerësimin e tyre. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaftë i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelsinë e kërkesëpadisë e në lidhmëri me

këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit nuk e ka pranuar pretendimin ankimor të palës së paditur të paraqitur me ankesë së gjykata e shkallës së parë ka qenë e obliguar që në seancë të ftojë edhe të paditurit e tjerë ndaj të cilëve paditësi e ka tërhequr padinë, ndërsa të njëjtit në cilësi të dëshmitarëve është dashur të deklarohen rreth pretendimeve nga kërkesëpadia. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë ka pasur material të mjaftueshëm për të vërtetuar themelësinë e kërkesëpadisë, të cilën nuk e ka kontestuar edhe vet i padituri i parë gjatë shqyrtimit kryesor të datës 10.01.2014. Si rrjedhojë referuar shkresave të lëndës rezultoi se me propozim të të paditurit të parë është konstatuar si e tërhequr padia ndaj të paditurve tjerë, ndërsa i padituri nuk ka propozuar që të dëgjohen në cilësi të dëshmitarëve këta të fundit gjatë zhvillimit të procedurës në shkallë të parë, por këtë rethanë e ka përmenduar vetëm me rastin e paraqitjes së ankesës, gjë që nuk është e lejuar dhe nuk mund të merret parasysh nga gjykata e shkallës së dytë, konform nenit 180 paragraf.1 të LPK-së.

Si rrjedhojë, nuk qëndrojnë edhe pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë, në aktgjykimin e atakuar, gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale për arsyeje se me nenin 17 të LMD-së parashihet se: *“pjesëmarrësit e detyrimit kanë për detyrë që t’u zbatojnë detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”* ndërsa neni 262 paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve parashihet se *“kreditore në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij”*. Në kuptim të këtyre dispozitave rezultoi se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka gjetur si të themeltë bazueshmërinë e kërkesëpadisë (pasi vet i padituri në seancën e datës 10.01.2014, e ka pranuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses), si dhe vendimin mbi shpenzimet procedurale, pasi që ky i fundit është marr në përputhje me nenin 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që ka rezultuar se nuk ka pasur pretendime ankimore nga asnjëra palë ndërgjyqëse në raport me vendosjen e gjykatës së shkallës së parë për pikën II dhe III të dispozitivit të aktgjykimin të atakuar, andaj edhe këto pjesë të dispozitivit të aktgjykimin kanë mbetur të pashqyrtuara.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.861/14, datë 26.11.2018

Kryetari i kolegjit,
Lumni Sallauka